



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.345, datë 23.09.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME
LIBRAZHD-PRRENJAS SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 23.09.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a.",

Vëren se:

1. Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas me shkresën nr. Prot. 179 datë 10.05.2021, me shkresën nr. Prot. 401 datë 09.08.2021 dhe me shkresën nr. Prot. 439 datë 10.09.2021 ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Librazhd-Prrenjas në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

- a) Shoqëria UK Librazhd-Prrenjas ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 21 181 banorë të Bashkisë Librazhd-Prrenjas ;
 - b) Drejtuese teknike e shoqërisë znj. Mirela Biba (Hoxholli) është diplomuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e inxhinierisë dega Hidroteknike në vitin 1993;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Librazhd-Prrenjas , të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Librazhd-Prrenjas është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a me (NUIS J68122606V), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Agron Gega
 - b) Drejtues Teknik – Mirela Biba (Hoxholli)
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a është Bashkia Librazhd-Prrenjas.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Librazhd-Prrenjas sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani